

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220-25-331-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 001-2025**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	ALLTON SH.P.K.
NUI	811923657
Adresa	Rruga Muharrem Fejza nr 4
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Allton Shpk
Adresa elektronike	allton.shpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	31.03.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 001-2025

Njoftimi per kontrate - 27.01.2025

Sqarimi per OE - 29.01.2025

Kerkesa per rishqyrtim -26.03.2025

Vendimi i kerkeses - 27.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Vendimi i kerkeses për rishqyrtim - 27.03.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia ne Trajtim/ jo-Diskriminimi

Neni 27 Dosja e tenderit

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me Njoftimin për Kontrate të Autoritetit Kontraktues dhe mbi refuzimin e kërkeses për rishqyrim të datës 26.03.2025, **Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 001-2025** me nr të prokurimit: **220-25-331-2-1-1** dhe nr. të brendshëm **001-2025**, duke pasur parasysh se në këtë aktivitet të prokurimit jemi palë me interes juridik material, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Në dokumentet e tenderit, konkretisht në nenin 8.1 dhe 8.2, është përcaktuar si **kërkesë për kapacitetin ekonomik dhe financiar**:

Raporti i auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion gjatë 3 viteve të fundit në vlerë prej jo më pak se 510,000.00 euro. Lideri i grupit duhet të përmbush 60% të kërkesës.

Ndërsa si **dëshmi dokumentare** është kërkuar:

Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Kjo paraqet një **mospërputhje të qartë** ndërmjet **kërkesës për raport të audituar**, e cila është një dokument financiar zyrtar i verifikuar nga kompani të licencuara të auditimit, dhe **dëshmisë së kërkuar**, që janë thjesht deklarata tatimore të dorëzuara në ATK, të cilat nuk përmbushin standardin e kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Kjo paqartësi dhe mospërputhje përbën shkelje të **parimit të transparencës dhe trajtimit të barabartë**, të garantuar nga neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik, dhe vendos operatorët ekonomikë në pozitë të pabarabartë, duke krijuar paqartësi të konsiderueshme në përgatitjen dhe vlerësimin e ofertave.

Gjithashtu ne si operator ekonomik kemi shqyrtuar dokumentet e tenderit dhe kemi vërejtur se tek përshkrimi i çmimit njësi matëse është përdorur orë në vend të metrave katrorë sepse, natyra e aktivitetit të pastrimit nuk matet me ore por matet me metër katror, prandaj AK formen të cilën e kanë prezentuar në orë është në kundërshtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Kërkojmë nga OSHP që t'i respektoj në përpikëri dispozitat e ligjit të prokurimit publik gjithashtu t'i respektoj kërkesat e veta të cilat vet i ka vendosur në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "Allton" SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 220-25-331-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 001-2025**" të inicuar nga Spitali Ferizaj.

KORRIGJOHEN kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 220-25-331-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 001-2025**" të inicuar nga Spitali Ferizaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

3000

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*